



Npi – 01/40 datë: 27.01.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 27.01.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -I-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, mbajtur më datë 27.01.2025 (e hënë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Nga OSBE-ja z.Mefail Mustafa, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit znj.Gentiana Mehmeti; Nga Zyra për Informim; znj.Vlora Hyseni dhe z.Albion Shabani; Zyrtarë i TI-së, z.Shpëtim Gashi. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.12.2024,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024,
3. Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim paraprak për dhënjën në shfrytëzim parcelat Komunale në Z.K-Shtime,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi-01/162 dt. 27.04.2023,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024,
7. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt,
8. Raport i punës së Kuvendit për vitin 2024,
9. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024,
10. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. Materialin nuk e kemi pranuar krejt, po bëhet fjalë për raportin e punës së Kuvendit.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Ne këtu po shprehim shqetësimin e banorëve të fshatit Zborc, që ka të bëjë me ndërtimin e Entit Special në rrugën për Zborc.Kërkesat tona janë pezullimi i menjëhershëm i projektit deri sa të bëhet një studim. Kështu që unë po kërkoj që me futë si pikë shtesë për të diskutuar në Kuvend për këtë çështje.

znj.Adelina Beqaj: Pajtohem me pikat e rendit të ditës ashtu sikurse në KPF. Pajtoj me propozimin e Përparimit, sepse nuk është mbajtur asnjë diskutim publik për këtë çështje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për këtë çështje mundet me dhënë përgjigje Kryetari. Edhe pse sa e di unë ka pas diskutime me banorët e fshatit Zborc. Mirëpo ne në Kuvend nuk kemi kurrfar kërkesë.

z.Përparim Ramusa: Ankesa i është drejtuar institucionit të Komunës përmes rrugëve ligjore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Meqenëse diskutime të tjera nuk ka për rendin e ditës po e hudhi në votim, së pari propozimin e rregullt që ka ardhur e pastaj nëse nuk kalon i hudhim edhe propozimet, ashtu qysh e parasheh rregullorja e punës.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim”, nuk e miratoi rendin e ditës të rregullt të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.**

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes me 11 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim”, miratoi rendin e ditës si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.12.2024,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024,
3. Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim paraprak për dhënjën në shfrytëz. parcelat Komun. në Z.K-Shtime,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi-01/162 dt. 27.04.2023,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindë. Npi-01/237 dt. 04.07.2024,
7. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt,
8. Raport i punës së Kuvendit për vitin 2024,
9. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024,
10. Pyetje – Përgjigje,
11. Diskutim për dislokimin e “Entit Special” në Shtime.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 24.12.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. Unë e pash me prioritet propozimin e Përparimit për të diskutuar për kërkesat e banorëve të fshatit Zborc. Mirë që po na përcjellin qytetarët dhe unë do të vazhdoj diskutimin kur të flasim për këtë pikë.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Pajtoj me procesverbalin jam “Pro” edhe pse ka disa gabime teknike por unë do ta votoj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstënim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin e Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 24.12.2024.**

Pika 2

Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Gojart Bajrami.

z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR: Përshëndetje. Sa i përket këtijë ndryshimi të rregullorja për Taksa për vitin 2025 që ka të bëjë me nenin 8.2 për vendosjen e tarifave për “Shërbimet profesionale për prerjen e pyjeve private”, unë kam pasë disa takime pune në Ministrinë e Bujqësisë. Kemi diskutuar dhe kemi ardhur në përfundim se në rregullore duhet të ekzistojnë qmimet për kryerjen e këtyre shërbimeve, sikurse ka qenë edhe të kaluarën. Me memorandum, Nr.02/280 të datës 19.12.2023, bëhet transferimi i stafit të pylltarisë nga Komuna e Shtimes në Agjencionin Pyjor të Kosovës, bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet, paisjet tjera dhe përgjegjësitë. Kështu pra ne si Komunë jemi të obliguar për me e zbatuar Udhëzimin Administrativ të MBPZHR Nr.07/2010 i cili ende është në fuqi, për sa i përket procedurave të dhënies së lejeve për prerje.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Ne këtë çështje e kemi diskutuar gjatë edhe në KPF ku kemi ardhur me rekomandim se ky është një obligim ligjor që duhet zbatuar, kështu që ne jemi “Pro”.

z.Përparim Ramusa: Ne jemi “Pro” zbatimit të obligimeve ligjore, por është shqetësues fakti sa i përket zyrtarëve ligjor të Komunës.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Edhe ne jemi “Pro” këtijë ndryshimi të rregullores për Taksa për vitin 2025 i cili po kërkohet nga Ministria. Mirëpo duhet ta kemi në Kuvend Zyrtarin Ligjor për me na sqaruar këtë çështje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -I- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 27.01.2025, unanimit, miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025, Npi-01/381 dt. 29.11.2024, si vijon:**

1. Te Neni 8, i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025, Npi – 01/381, të datës 29.11.2025, bëhen këto ndryshime si vijon:

8.2 Shërbimet profesionale për prerjen e pyjeve private:

8.2.1 Dru zjarri për m³ në shumën prej1.50 €

8.2.2 Dru zjarri për 7m³ në shumën prej2.00 €

8.2.3 Dru teknik për 7m³ në shumën prej3.00 €

Pika 3

Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Materialin për këtë pike e keni marrë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do të ndalem në detaje, por në pikat kryesore. Ne e kemi obligim ligjor që ta prezantojmë raportin vjetor buxhetor para Kuvendit. Në vazhdim lexoi pikat kryesore të raportit sipas shifrave të radhitura nëpër kategoritë ekonomike (shih raportin). Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur, Ju ftoj që ta votoni, sepse në vitin 2024 e kemi një buxhet të realizuar si kurrë më parë në shumën prej 11,043,479.98 euro ose 97.20%.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Lëshimi i Lejeve ndërtimore ka rënë në 11.77% cila është arsyeja e kësaj rënje, a nuk ka kërkesa për ndërtim apo cila është arsyeja?

znj.Adelina Beqaj: Pse nuk po na i paraqitni të dhënat për shpenzimet në dreka zyrtare, sa kanë qenë këto shpenzime dhe për far arye?

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Raporti është përpiluar mire, dhe në këtë raport janë paraqitur të dhënat e sakta të shpenzimeve buxhetore. Buxheti është shpenzuar 97.20% ku konsiderohet si vit i suksesit. Prandaj ne si grup parlamentar LDK-AKR do ta votojmë.

z.Reshat Mujota: Në dy kolona të raportit të Zyra e Kryetarit janë dy kategori mallra dhe shërbime si dhe paga dhe mëditje, kështu që të Administrata të pagat dhe mëditjet në raport me Zyrën e Kryetarit po na del një diskrepancë, a mundesh me na e sqaru drejtor këtë diskrepancë? Kryesues le të na sqaron Muhameti a janë në Koalicion me LDK-në.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Unë e di që AKR-ja është në koalicion me LDK-në që nga fillimi dhe unë nuk e di që janë ndarë.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Sot këtu po flasim për një Buxhet të vitit 2024 i cili është shpenzuar rekord si kurrë më parë me 97.20%. Një gjë është e qartë se asnjëherë nuk është shpenzuar buxheti kështu si ky. Kundërshtimet që po vijnë nga opozita kanë vetëm një qëllim e ai është electoral. Kur dikush e lexon këtë raport duhet me u mburrë për nivelin dhe mënyrën e shpenzimit të tij. Kështu tregohet publikisht se si duhet shpenzuar paraja publike. Prandaj ne do ta përkrahim dhe do ta votojmë raportin për shpenzimet e vitit 2024.

z.Përparim Ramusa: Më nxiti parafolisi që po lëvdohet, për me diskutuar. Po marrim si shembull të hyrat e inkasuara në vitin 2023 ku ka pas më shumë se sa në vitin 2024, e që nënkupton që kemi ramje. Pastaj te lejet ndërtimore gjithashtu kemi ramje, kemi edhe shumë shembuj të tjerë ku keni ramje. I keni shpenzuar 11 milion euro por asnjë punë nuk e keni kryer. Unë e di që i keni shpenzuar por nuk janë shku në interes të qytetarit por i keni vjedhur, dhe prej tyre 50% i ka vjedhur ekzekutivi i Komunës.

z.Asllan Beqaj: Te pjesa e inkasimit të tatimit, ju fort mire e dini që i kemi falur nga 100 euro për tatimpaguesit tanë, pse nuk po e përmendni edhe kështu sepse ju e dini kështu fort mirë. Sa i përket realizimit të projekteve, ju a nuk po i shihni parqet e ndërtuara. Këtu thenë nuk bëhet Çerdhja, tash siç po e shihni po bëhen të gjitha, edhe duhet me i pa dhe me i thënë sepse ato janë për të gjithë banorët pa përjashtim. Punëve të mira duhet me ju gëzuar të gjithë pra edhe ju.

z.Reshat Mujota: Unë çdo punë të mirë i gëzohem, por unë nuk e morra përgjigjen për sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare.

z.Besnik Seferi: Mënyra e të shprehurit në Kuvend po më duket absurde. Për sa i përket raportit të shpenzimeve, u diskutua dhe u dhanë sqarime. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit janë pasqyruar në raport mjaft mirë dhe në mënyrë reale ashtu qysh janë shpenzuar. Realizimi i buxhetit për vitin 2024 me 97.20% është një realizim shumë i suksesshëm. Ne mund të diskutojmë se ku ka ngecur komuna me realizimin e projekteve, por jo sepse vetëm po dëshirohet të hedhet baltë në gjithçka që është bërë. Vërtetë janë bërë punë të mira në projekte të ndryshme si në kanalizime, rrugë, ndriçime etj. Për sa i përket pikes shtesë për dislokimin e Entit Special, po bëni përpjekje me i dhënë kahje krejt tjetër por nuk do të ndodhë sepse është projekt shumë i rëndësishëm që do të realizohet. Ne jemi "Pro" këtijë raporti.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. E falënderoj drejtorin për raportin. Vetë përqindja e realizimit të buxhetit me 97.20% tregon një realizim shumë të suksesshëm. Ky realizim me këtë përqindje gjithashtu tregon se janë realizuar edhe shumë projekte në interes të qytetarëve tanë, edhe përkundër faktit që ju si opozitë nuk e keni votuar buxhetin. Këto projekte qytetarët tanë po i shohin shumë mirë, përkundër jush si opozitë që nuk po i shihni.

znj.Adalina Beqaj: 32.000 euro i keni shpenzuar për dreka zyrtare. Pse rruga "Mehdi Korrani" është prishë që posa e keni shtruar. Kjo pra është një dështim total i ekzekutivit. Është mirë që të sillesh pak te niveli lokal e leje nivelin qendror.

z.Përparim Ramusa: Zonja Veliu po na mbanë ders, se si ne nuk e kemi votuar buxhetin e 2024. Ty PDK-ja të ka shti në punë, e Vetvendosja të ka qit prej punë edhe ti sot këtu folë keq. Sa i përket Besnikut, banorët e Zborcit nuk janë të kënaqur me lokacionin e jo me dislokimin.

z.Besnik Seferi: Unë nuk kamë parë kurrfarë kërkesë për këtë pikë. Kjo ka mundësi të trajtohet te pika e rendit të ditës, Pyetje-Përgjigje. Unë së paku mundohem mos me bërë politikë, dhe jam i popullit.

znj.Zejnije Veliu: Unë përkundër disave, më parë e kam kryer fakultetin e pastaj kamë hy në punë dhe politikë. Kritika konsideroj unë se është e dobishme, por ju si opozitë nuk jeni duke dashur me pa asnjë projekt të realizuar.

z.Asllan Beqaj: Shkurtimisht, Ju sa ishit ne pushtet për dreka zyrtare i keni shpenzuar vetëm brenda një muaji 5000 euro, e që ja keni kaluar edhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Nuk shkohet tash sikurse keni shkuar ju me shikuar ndeshje futbolli me para të taksave të qytetarëve. Kështu që ju jeni kampion për shpenzime të drekave zyrtare. Ju duhet ta dini se edhe tashë edhe atëherë ato kanë qenë para të qytetarëve dhe duhet dhënë llogari për shpenzimin e

tyre. Ju vazhdimisht keni pengë në realizimin e projekteve, por pavarësisht kësaj projektet do të ecin përpara.

z.Rexhep Gashi: Është pikë e rëndësishme ky raport i shpenzimeve. Çdo projekt duhet përshëndetë. Paret nga taksat e qytetarëve duhet të kthehen me projekte. Buxheti nuk është votuar sepse ka pasur projekte nën 10.000 euro. Kemi investime kapitale, dhe ju po bëni populizëm. Tregu i gjelbër është nisur para tri viteve, ku është gjendja e tregut tani? As qereku i projekteve nuk është realizuar, filluar po por jo përfunduar. Kërkoj kilometrazhat e automjeteve zyrtare se sa kanë shpenzuar gjatë vitit. Po ashtu edhe për dreka zyrtare sepse 9.200 euro nuk janë pak.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Deshta me shut këtu diçka se nuk e di ndoshta janë shumë ose pak 10.000 euro por është me rëndësi mënyra se si janë shpenzuar. Psh. Nëse e merrni faturën për me e kompenzu drekën që e keni hanger këtu qka i thuani kësaj. Tjetër çka po bëni me kamionin që u ka ardhur nga Gjermania, pse nuk po e aktivizoni? Tash në fund të mandatit vetëm gurthemele po vendosni. Nuk keni asnjë projekt të madh të përfunduar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Duhet ti shihni projektet. Rruga "Mehdi Korrani" në Petrovë është shtruar shtresa e pare e asfaltit, ndërkaq që pjesa e dytë do të shtrohet në pranverë. Pastaj te Lumi, është përfunduar Palestra Sportive në Pjetërshticë, por vetëm duhet parë.

z.Gzim Haxhiu: Përshëndetje. Vërejtje për diskursin e diskutimeve që po zhvillohet në Kuvend. Ky raport nuk është se dallon nga raportet tjera.

z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. E kamë një shqetësim për sa i përket qasjes në dokumente publike. Disa here kamë bërë kërkesë. Herën e fundit më kanë thënë me pritë 7 ditë e pastaj edhe 15 ditë. Kjo tregon se kanë për qëllim me mshefë të dhëna. Dikush i përmendi 10.000 euro, kemi shpenzime të byfësë mbi 7000 euro Kuvendi dhe Kryetari. Kjo është esenca, që të mshifen të dhënat. 856 euro janë paguar në hotel Emerald, ne duam ta dimë se për çka janë paguar.

znj.Zejnije Veliu: Meqenëse këta nuk po duan me i pa projektet atëherë po duhet me i përmendë, Projekti i Observatorit në Rashincë, Investime në ndriçimin publik gjithandej nëpër gjitha fshatrat dhe qytet, Investimet e mëdha në renovimin e shkollave, e në kohën e juaj me u pas punuar mirë këto shkolla sot nuk kishte me pas nevojë për renovime bazike. Projekti i unazës së vogël që e ka liruar në masë të madhe komunikacionin nëpër qendër të Shtimes. Rruga e asfaltuar Godanc-Zborc, edhe shumë rrugë e rrugica në brendi të fshtrave, së bashku me ndriçimin e kanalizimin. Punë të mira janë duke u bërë në vazhdimësi, dhe qytetari po i sheh dhe vlerësimin do ta jep me votë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Faleminderit për pyetjet. Te të hyrat te tatami në prone, është inkasimi më i vogël për arsye se siç edhe e dini i kemi falë nga 100 euro për tatimpaguesit, dhe kjo ka pas ndikim direkt. Sa i përket shpenzimeve në shumën prej 7.520 euro këto janë shpenzime ku janë të përfshira edhe shpenzimet që janë bërë për sa i përket pritjes për familjet e dëshmorëve, pritjet për mërgimtarët tanë, për nxënës, për Kuvendin etj. Sa i përket shpenzimeve për derivate, këtu hyjnë shpenzimet e derivative për automjete, për nxemjen qendrore të komunës, për Agregatë etj. Sa i përket kërkesës për qasje në dokumente publike, për sa i përket të dhënave që i gjeneron sistemi mund ti merrni menjëherë, por jo edhe të dhëna që janë për nevojat të drejtorisë, edhe jo të dhëna që bijnë në kundërshtim me ligjin për të dhënat personale.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje. Frustrimin e opozitës po e vërejnë mirë edhe qytetarët. Buxheti i komunës për vitin 2024 është realizuar në përqindjen rekorde prej 97.20% prandaj kjo qeverisje quhet efikase, duke e shpenzuar buxhetin në mënyrën më të mirë të mundshme. Tani për Shtimen nga buxheti qendror janë buxhetuar rreth 48 milion euro për projekte që do ti gëzon qytetari i komunës tonë por jo vetëm. Sa i përket të hyrave e shpjegoj drejtori se ne i kemi falur nga 100 euro për qytetarët tanë tatimpagues që shuma sillet rreth 300.000 euro, dhe kjo mendoj unë tregon një kujdes të shtuar për banorët e komunës tonë. Sa i përket shpenzimeve këtu u tentua me u manipuluar me të dhënat dhe me mënyrën e shpenzimit, por faktet janë se ne jemi komunë dinamike, ku këtu ka pas gara në shumë fusha, ka pas aktivitete të shoqatave e organizatave, pastaj kemi pas delegacione të jashtme si nga Gjermania, Kroacia, Japonia nga të

cilët edhe kemi pas përfitime direkte për komunën tone. Kemi pas edhe vizita nga udhëheqës të lartë të shtetit të cilët na kanë sjellë dhe po na sjellin shumë projekte konkrete në komunën tonë. Dhe krejt këto shpenzime që u përmendën janë më pak se 8000 euro. Këtë përpjekje tonën për kursim, në raport me miqët që po na sjellin dobi dhe projekte do ta vlerësojë më së miri qytetari.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

***Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për”, me 10 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstenim”, (Kryesuesi i Kuvendit duke përdorur të drejtën për votën shtesë në rast të votave të barabarta, ku ka votuar “Për” bazuar në nenin 48.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040) me 11 vota “Për” miratoi Raportin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2024.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Po shkojmë në pauzë të drekës në ora 12:04h dhe kthehemi në mbledhje në ora 13:15h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vazhdojmë me mbledhjen e Kuvendit në ora 13:29h. Kemi përfunduar pikën e 3 dhe tani po vazhdojmë me pikën e 4 të rendit të ditës.

Pika 4

Propozim-Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim parcelat Komunale në Z.K-Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtorit Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Bazuar në nenin 4 dhe 8 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Kuvendi duhet të miratoi një vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale. Këto prona janë në listën e pronave për me i dhënë në shfrytëzim. Lidhur me këtë vendim kemi disa kërkesa nga bizneset për vendosje të paneleve solare, kështu që qëllimi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim ka të bëjë me prodhimin e energjisë së ripërtrishme. Lidhur me kërkesat për prodhimin e energjisë solare komuna e Shtimes premton zhvillim të shpejt të këtijë sektori, kështu që edhe bizneset e kanë vërejtë këtë dhe po nguten të gjejnë hapsirë të mjaftueshme. Kemi 14 hektarë tokë komunale mbi Hallën e Sportit. Po ashtu edhe 8 hektarë nën Hallën e Sportit, mirëpo nuk është e thanun që ne me e dhënë krejt sipërfaqen në shfrytëzim. Parakusht dhe si motiv shtesë për këtë lloj investimi atje është ndërtimi i Nënstacionit Elektrik prej 110KW që pritët të ndërtohet së shpejti. Në fund ju ftoj që ta miratoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa: Qytetarëve më duhet me ju drejtuar sepse jemi para kamerave, se Kryetari na ofendoj duke na thënë se po uluroni. Te propozimi i juaj e kemi thënë në KPF-ë se ne si PDK-ë qëndrojmë në përkrahjen e bizneseve.

z.Kadri Emini: Unë uroj që të ketë investime në këto parcela, kështu që ne jemi “Pro” dhe do ti mbështesim.

z.Besnik Seferi: Edhe ne si grup parlamentar i LVV-së jemi “Pro” dhe urojmë që të bëhen investimet që po pretendohen.

z.Lumni Amrushi: Meqenëse po bëhet fjalë për prodhimin e energjisë së ripërtrishme, jemi të interesuar me na sqaruar procedurën e dhënies së pronës në shfrytëzim? Këtë e kemi kërkuar edhe në KPF-ë.

z.Rrahman Jakupi: Më datën 13.09.2023 është bërë një kërkesë për një park solarë. Ka pas me investu 300 milion euro në Shtime. Pas kacafytjeve që kanë ndodhur të Kryetarit me përfaqësuesin Gjerman ai ka ikur, dhe tani sot na vjen me një kërkesë të tillë. Ku pe dini ju për parkun solarë, kur kjo shpallet me interes të përgjithshëm.

z.Rexhep Gashi: Faleminderit për sqarimin. Ne e përshëndesim çdo investim. Po bëhet fjalë për dy parcela, njëra e klasës së tretë dhe tjetra e klasës së katërt. Një prone të klasës së tretë një her na e ka kthyer Ministria mbrapa për rishqyrtim. Qysh jemi me procedurat ligjore?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: E thash se parcelat gjinden në listat e pronave që mund të ipen në shfrytëzim. Këtu pra po bëhet fjalë për prodhimin e energjisë së ripërtrishme që është

miqësore me ambientin. Pas këtijë vendimi Kuvendi e formon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve mbi bazën e kriterëve të përcaktuara me ligj. Komisioni e miraton një Rekomandim i cili më pas vjen në Kuvend për miratim. Mund të them se ky projekt është në përputhje të plotë me Planin Zhvillimor. Sa i përket 300 milion eurove investime që u thanë këtu, unë nuk e di dhe nuk i kam pa këta investitor në Komunën tonë ashtu siç u tha. Por edhe sikur të jetë kjo e vërtetë ashtu siç u tha nga anëtarë i Kuvendit, Komuna e Shtimes nuk ka tokë për një investim marramendës, të tillë, madje nuk ka as edhe sikur ti merret edhe ekonomis pyjore, prandaj kjo nuk qëndron fare. Teknikisht nuk ka mundësi një gjë e tillë sepse për një milion euro investime në këtë fushë nevojiten rreth 40 hektar tokë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 20 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstënim" miratoi Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

1. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-01403-0, me sipërfaqe prej: 140629m², Kultura - Kullosë e klasit të -IV- (katër). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi "Komuna e Shtimes".
2. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-02295-30, me sipërfaqe prej: 81157m², Kultura – Mal i klasit të -III- (tretë). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi "Komuna e Shtimes".

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit,

Npi-01/162 dt. 27.04.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi. **znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS:** Përsëendetje. Ne kemi përgatitur një ndryshim të vendimit për rritjen e çmimit nga 250 në 300 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës tonë, duke pasqer parasysh rritjen e gjithanshme të çmimeve. Ky propozim ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe ju ftoj që ta miratoni. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përpiqem të përgjigjem.

z.Muhamet Ademaj: Ne si grup parlamentar LDK-AKR e përkrahim këtë ndryshim përkatësisht rritjen e pagesës për shërbimet e varrimit nga 250 në 300 euro.

z.Përparim Ramusa: E konfirmoj rekomandimin e KPF-së, kështu që ne e përkrahim këtë ndryshim.

z.Besnik Seferi: Edhe ne si grup parlamentar i LVV-së e mbështesim një shumë të tillë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e çmimit në vlerë prej 300 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët që varrosen në territorin e kufijve administrativë të Komunës së Shtimes.**

Pika 6

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj

Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindë. Npi-01/237 dt. 04.07.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi. **znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS:** Fillimisht unë i falënderoj tri familjet të cilat i strehojnë dhe përkujdesen për fëmijët që janë pa përkujdesje prindërore. Sigurisht që kemi rritje të çmimeve, dhe këto familje kanë sfida për ti rritur këta fëmijë, dhe për këtë arsye ne kemi propozuar, ndryshimin e vendimit Npi-01/237 për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore, duke propozuar rritjen e shumës në 150 euro në muaj. Nëse ka pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ta miratoni, meqenëse ka kaluar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa.

z.Rexhep Gashi: Faleminderit, Kuvendi ka bërë mirë që e ka bërë një hap të tillë. Nëse përkrahet edhe nga kolegët unë propozoj që shumën mujore ta bëjmë 200 euro, dhe është për me i përshëndetë gjitha këto familje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të vijë propozimi këtu në kuvend janë bërë disa kalkulime financiare, ku na ipet një pasqyrë e qartë se kaq është mundësia financiare, dhe ne duhet të përmbahemi përkundër dëshirës tone që këtyre familjeve tu ndihmojmë edhe pak më shumë.

znj.Adelina Beqaj: Rashë unë e po i njohim këto familje, se kurrë nuk i kishi njoftë. Unë e përkrahu propozimin e Rexhepit, që shuma prej 150 euro të rritet në 200 euro për muaj për secilën familje.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për një propozim të tillë, dhe njëkohësisht i falënderojmë këto familje. Unë po e shoh që Kuvendi e ka vullnetit që shuma të rritet në 200 euro, kështu që edhe unë e ndryshoj mendimin tim që e kamë dhënë në KPF-ë për 150 euro dhe propozoj që shuma të jetë 200 euro për muaj.

z.Reshat Mujota: Edhe unë pajtoj që shuma mujore të jetë 200 euro ashtu qysh u propozua nga kolegët. Kështu që edhe unë do ta votoj këtë shumë.

Z,Besnik Seferi: Po lidhem me diskutimin e koleges Adelina, se këto familje ne i kemi njohur qysh moti, sepse unë jamë rrituar aty afër, dhe i njoh shumë mirë. Duke i parë këto familje se si bëjnë përpjekje për rritjen e këtyre fëmijëve unë propozoj që shuma të rritet në 220 euro për secilën familje.

z.Kadri Emini: Unë e përgëzoj drejtoreshën për propozimin e sajë. Unë mendoj se është shumë e lehtë me ba propozime, por unë dua ta di faktikisht se a ka mundësi financiare që të bëhet kjo rritje apo jo?

znj.Zejniye Veliu: Duhet ta dimë se çka po flasim e çka po propozojmë, duke marrë për bazë mundësitë financiare. Mjafton që këto familje tash me këtë qeveri po ndihmohen nga Komuna, është filluar me 100 euro tani po shkojmë me rritje për 150 euro dhe unë besoj se çdo vit do të ketë rritje. Ne kemi biseduar me këto gra për kushtet dhe mundësitë e tyre. Ne po ashtu jemi në dijeni se është në procedurë një Ligj i veçantë për trajtimin e këtyre rasteve dhe ndihmën për këto familje sikurse që do tu njihet edhe përvojë e punës lidhur me përkujdesjen për këta fëmijë. Përkundër kësaj edhe ndihma e Komunës do të jetë e mirëseardhur për këto familje.

z.Reshat Mujota: Këto familje kur i kanë marrë fëmijët nuk kanë llogaritur në këto paga, ata i kanë marrë fëmijët vullnetarisht dhe pa kompensim nga Komuna. Kështu që unë po propozoj që kjo le të jetë rritje e dinjitetshme, qëndroni në propozimet që u dhanë dhe mos ta zgjasim më shumë.

z.Muhamet Ademaj: Unë mendoj se shuma prej 150 eurove është simbolike, prandaj unë e kam një pyetje për drejtorin e financave se a ka mundësi me u rritë më shumë?

z.Rexhep Gashi: Nuk pata unë këtu të bëj me populizëm. Kërkoj falje, unë nuk thash se ju mjaftojnë këto mjete. Meqenëse kjo shumë është për familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore, unë mendoj se e meritojnë. Unë mendoj se për një ngritje edhe për 50 euro nuk paraqet ndonjë problem.

z.Përparim Ramusa: Për ne si grup parlamentar është vullneti për rritje, kështu që cilin propozim që ta nxjerrësh në votim ne do ta votojmë.

z.Besnik Seferi: Kërkoj një sçarim nga drejtoria nëse nuk ka problem financiar për me rritë në 220 euro. Dhe dua që ti sqaroj kolegët se unë këtu nuk jam duke bërë populizëm por është propozim që mendoj se e meritojnë këto familje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Mundësitë dhe dëshirat nuk po përputhen nganjëherë. Kështu pra me shumën prej 150 eurove kemi votuar edhe në KPF-ë. Po më vjen keq nga këto familje sepse dëshira është më e madhe por mundësitë financiare janë për 150 euro.

z.Reshat Mujota: Është mirë që informatat me na i dhënë drejtoresha e jo ti Kryesues. Po e lëmë si pikë të hapur, e Kuvendi vendos "Për" ose "Kundër". Ndërsa sa i përket KPF-së ajo jep vetëm një rekomandim.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: I falënderojmë edhe një here familjet për kontributin e tyre në këtë kuptim. Propozimet janë të mira por për fat të keq mundësitë nuk janë

në favor të rritjeve më të mëdha. Prandaj unë ju ftoj që ta miratoni propozimin që e kemi bërë ne dhe i cili ka marrë miratimin edhe në KPF-ë me shumën prej 150 eurove.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 10 vota “Abstënim”, miratoi Vendimin për ndarjen nga 150 € për ç’do muaj, për secilën familje që ka strehuar fëmijë pa përkujdesje prindërore në Komunën e Shtimes, deri më 31.12.2025.**

Pika 7

Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Draft-Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt është punuar, së bashku me Organizata të ndryshme ndërkombëtare siç janë GIZ- Gjerman etj. Ky plan është i mirë sepse është plan i integruar i cili i përfshinë rajonet e Gjilanit dhe Ferizajt e në këtë kuadër edhe Shtimen, dhe është kërkuar të miratohet në Kuvendet, prandaj unë ju ftoj që ta miratojmë fillimisht vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik e pastaj më vonë krejt planin.

Në vazhdim Kryesuesi konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 8

Raport i punës së Kuvendit për vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi: Unë nuk kamë çka me diskutu për këtë pikë, dhe nuk e di se çka mund të diskutojmë kur për këtë pikë nuk e kemi marrë materialin.

z.Besnik Seferi: Edhe unë mendoj se do të ishte mirë që ta kemi materialin.

z.Përparim Ramusa: Unë propozoj që këtë pikë ta shtyjmë për mbledhjen e radhës të Kuvendit, sepse për këtë pikë qytetarëve nuk është se u intereson aq shumë.

znj.Adelina Beqaj: E keni bërë rregull mos me e pru materialin me kohë. Kështu që aty në raport i keni përfshi edhe vendimet që janë kthyer nga Ministria.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Nuk ka këtu te ky raport asgjë që do të fshihej, vendimet që janë kthyer nga Ministria i kemi miratuar këtu bashkërisht dhe i dime të gjitha, por unë edhe mund tua lexojë raportin në pikat Kryesore. Kuvendi gjatë vitit 2024 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, 1 të Jashtëzakonshme, 5 mbledhje solemne, Kuvendi ka miratuar 78 Vendime, 5 Rregullore, 10 janë Plane-Strategji-Korniza-Buxhet. Vendime të kthyera nga MAPL-ja janë 9 prej tyre 7 janë rishqyrtuar nga Kuvendi dhe 2 janë në procedurë. Raporte të Kryetarit në Kuvend janë 2. Kjo është pra në pika të shkurta puna e Kuvendit në vitin 2024.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit për raportin. Uroj që puna e mirë e Kuvendit të vazhdojë edhe në vitin 2025 së bashku me opozitën. Kështu që ne do ta miratojmë këtë raport të punës së Kuvendit për vitin 2024.

z.Reshat Mujota: Ne duhet me pas raport të punës së Kuvendit, dhe për me përpilu raportin e punës është punë e jotja Kryesues në bashkëpunim me sekretarinë e Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 7 vota “Abstënim” miratoi Raportin e Punës të Kuvendit për vitin 2024.**

Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Faruk Beqa.

Nënkryetari, z.Faruk Beqa: Përshëndetje. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi gjatë vitit 2024 ka mbajtur 6 mbledhje më datat si vijon: 23.02.2024, 25.04.2024, 26.06.2024, 24.09.2024, 23.10.2024, 23.12.2024. Me temat si vijon: 1. Siguria e përgjithshme në Komunën e Shtimes, 2. Informatë nga policia Njësia në Shtime, 3.Informatë nga Drejtoria për shërbime Publike, 4.Informatë nga Njësia e Zjarrfikësve, 5.Informatë nga Drejtoria Komunale për Arsim, 6.Informatë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, 7.Diskutim për parandalimin e ekstremizmit, 8.Diskutim për portalet që sjellin lajme të rreme dhe pasojat për publikun, 9.Luftimi i narkomanisë në shkollë dhe hapsira publike, 10.Zbatimi i masave për sigurinë në punë, 11.Parandalimi i dhunës në familje, 12.Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesat për mjetet piroteknike.

Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar (shih dokumentin), nëse ka ndonjë pyetje në këtu mund ta diskutojmë bashkërisht.

z.Hasan Avdyli: Përshëndetje. Faleminderit për këtë informatë për punën e KKSB-së për vitin 2024. Siç e dimë KKSB-ja në punën e vetë qëllimin kryesor e ka që të kontribuojë në sigurimin e qetësisë dhe një ambienti më të favorshëm për jetesë. Mirëpo për fat të keq në teren kemi një situatë shumë më keq, psh. për sa i përket pronave, pastaj e kemi mjaft shqetësues çështjen e qenëve endacak që po paraqesin rrezik për banorët sidomos fëmijët. Në Informatë nuk është përmend dukuria e sjelljes asociale të rinjëve, sidomos të një rasti në mes të rinjëve që ka ndodhur këto e nuk është përmendur në informatë. Përgjegjësit sigurisht që duhet kërkuar fillimisht të prindërit pastaj të shkollë dhe të institucionet edukativo arsimore. Institucionet duhet të kenë listën e të rinjëve problematik për ti trajtuar më seriozisht. Unë po kërkoj që me këtë rast i keqtrajtimit të një të riu që ka ndodhur këto ditë të merren organet seriozisht dhe të merren masat që edhe familjet të merren vesh dhe mos të ketë mundësi që rasti të keqinterpretohet.

znj.Albana Podvorica: Përshëndetje. Unë e kam lexuar këtë informatë, si prind por edhe si Kryesuese e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, na ka prekur rasti i keqtrajtimit të një të riu të cilin e kemi pa përmes rrjeteve sociale. Nga Kryetari po kërkoj sqarimin e këtij rasti. Kemi edhe dy tema tjera siç janë ekstremizmi dhe lajmet e rreme. Unë mendoj se Policia duhet të rritë angazhimin e tyre për parandalimin e këtyre rasteve, sepse mund të biem edhe ne pre e këtyre.

znj.Adelina Beqaj: Vërtetë na ka prekur rasti i fundit, është shqetësues, dhe unë po kërkoj zbardhjen e rastit dhe po uroj që mos të kemi më këso rastesh. Drejtoresha e DKA-së ka një përgjegjësi, për këtë rast e cila nuk është në mbledhje për të na sqaruar pak.

z.Muhamet Ademaj: Situata e sigurisë në komunën tonë është e qetë. Lidhur me këtë rast unë kam informata se nxënësit kanë qenë problematik. Mendoj se është mirë që ne ti rrisim masat e sigurisë. Unë i njoh prindërit e tyre dhe është mirë që të bisedohet me ta që rasti mos të rritet.

z.Përparim Ramusa: I tha të gjitha kolegu Hasan Avdyli. Sipas parafolsit një drejtor e ka lënë detyrën për shkak të një nxënësi problematik. Ju lutem me na dhënë sqarime për këtë deklaram.

z.Reshat Mujota: Edhe unë po e kërkoj nga profa këtë sqarim për ushtruesin e detyrës.

Nënkryetari, z.Faruk Beqa: Faleminderit për diskutimet dhe pyetjet. Me rastin që po e diskutojmë ne jemi marrë shumë seriozisht. Ky i ri është i moshës së mitur. Shkollë i ka kry të gjitha procedurat sipas protokolit, dhe janë marrë të gjitha masat. Po ashtu edhe DKA-ja e ka kryer punën e vetë. Me rastin është marrë dhe po mirret Qendra për Punë Sociale. Po ashtu edhe Policia dhe Prokuroria për fëmijë janë marrë me këtë rast. Edhe ne si Komunë jemi marrë dhe po merremi ende për ta menagjuar rastin si duhet. Kështu që është bërë edhe anomneza mjekësore e nxënësit dhe ka rezultuar se duhet me u marrë me trajtimin e rastit nga Psikologu për fëmijë Pedagogu, Sociologu etj. Deri tani janë marrë të gjitha masat dhe ende po mirren që ky rast të merr një epilog të mirë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Mendoj se duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm kur flasim për këtë rast që ka ndodhur mes dy nxënësve të moshës së mitur sepse ndoshta edhe mund të bëjmë shkelje të privatësisë. Institucionet kanë qenë të shshqetësuara po aq sa edhe qytetarët, mirëpo ata kanë vepruar dhe kanë marrë masat e duhura menjëher. Unë po sa e kam marrë informacionin e kamë thirrë një mbledhje të përbashkët me Policinë, DKA-në, QPS-në, dhe Drejtorin e Shkollës. E kemi diskutuar dhe kemi ardhur në përfundim se po bëhet fjalë për një rast të kacafytjes në mes të dy nxënësve mjaft problematik të klasës së 6 fillore, ku këta kishin pas shpesh zënka edhe më parë, ku edhe ishin marrë masa konkrete ndaj tyre, por ata i kanë përsëritur vazhdimisht zënkat e tyre. Në mbledhje ne u morëm vesh që Institucionet secili me kry punën që i takon për sa i përket këtijë rasti, si dhe të ketë një bashkëpunim me familjarët e këtyre nxënësve. Këta fëmijë duhet resocializuar dhe duhet të merret seriozisht institucioni për trajtimin e tyre. Prokuroria e Ferizajt ka deklaruar se nuk mund të merren në përgjegjësi fëmijët nën moshën 14 vjeqare. Rasti po trajtohet dhe po monitorohet, kështu që neve na vjen keq që ka ndodhur ky rast, dhe për këtë arsye ne kemi qenë te familja e nxënësit të komunitetit ashkali, dhe ju kemi gjindur afër nëse ka nevojë për ndihma. Lutemi që kjo mos të përsëritet më askund.

Pika 10

Pyetje - Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota: Pyetja ime është pse nuk më janë kthyer përgjigjet, në pyetjet e kaluara, dhe kur do ti marr përgjigjet? Dhe po ashtu kërkoj që të përsëriten pyetjet e mija nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

z.Rexhep Gashi: Është shqetësuese sepse i kemi bërë 22 pyetje e nuk e kemi asnjë përgjigje. Pyetjet janë nga qytetarët. Pyetje për Administratën, pse veteranët e luftës i cili nga propozimi kryesor ka kaluar në Kuvendin e Komunës së Shtimes për një lehtësim, veteranët e luftës një taks nga 10 euro të automjeteve, pse nuk është duke u përfillë ata veteran që e kanë të skaduar vërtetimin apo antarsimin e shoqatës duke e prezantuar Certifikatën?

Drejtori i drejtoris përkatëse: Çfarë është kah ndodhë me tregun tërëditor, ku janë procedurat e tijë?

z.Muhamet Ademaj: Unë kamë këto pyetje për DPUKGJ-ë, sa leje ndërtimi janë lëshuar gjatë vitit 2024?

znj.Albana Podvorica: Unë kamë këto pyetje: Pyetje për DKA-në, pse po përsëriten problemet me ngrohje te shkolla "Emin Duraku" ndoshta ka pas problem edhe më parë sepse ka pas orë me kohzgjatje të shkurtuar? Pyetje për DSHP-në, në rrugën "Anton Çeta" ka çrregullim të ndriçimit publik, pastaj trotuari nuk është në gjendjen siç ka qenë më përpara mëparshme, mosvendosja e kockave po i pengon edhe lëvizjen e qytetarëve në këtë pjesë, kamë kërkesë nga banorët e lagjes që ta ngris si shqetësim dhe kërkesa është që të rregullohen sa më pare trotualet përpara lokaleve të bizneseve në rrugën "Anton Çeta"? Pytje tjetër është, rruga "Lutfi Bilalli" kur do të bëhet me ndriçim? Pytja e fundit kur ka me u ba trotuari te shkolla "Emin Duraku" te rruga "Skender Salihaj"?

Pika 11 (Shtesë)

Diskutim për dislokimin e "Entit Special" – Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa: Këtu po bëhet fjalë për dislokimin e dy institucioneve "Entin Special" dhe "Enti për të sëmurit kronik psikik". Ne si PDK-ë nuk jemi kundër dislokimit, por duhet ti trajtojmë kërkesat e banorëve të fshatit Zborc me 230 nënshkrime. Te këto dy institucione kemi decentralizim, dhe qëllimi i qeverive të kaluara ishte që këto me i minimizue ose me i dërgue nga komuna e Shtimes dikund tjetër. Lokacioni është i gabuar sepse prap është afër vendbanimit. Unë në emër të PDK-së jam me peticionin e banorëve të fshatit Zborc të cilët po e kundërshtojnë lokacionin. Në atë lokacion ne mendojmë se duhet të bëhen projekte tjera. Nuk

është bërë asnjë debat me banorët. Kërkojmë që Kryetari të shkojë dhe të bëjë debat me banorët dhe ta shtyjë përpara këtë punë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Për hirë të qytetarëve të dhe banorëve të fshatit Zborc, do të sqarojë këtë projekt shumë të rëndësishëm për komunën tonë. Këtu nga opozita gjithqka po tentohet të politizohet. Edhe për planifikimet buxhetore të miratuara në këtë Kuvend po tentohet të dezinformohen banorët e komunës tonë. Edhe sa u përket familjeve dhe shtresave më të ndjeshme siç janë Nënata Lebona, fëmijët etj. nuk u ka ra ndërmend 20 vjet me ua nda qoftë edhe një cent, e tash po po kërkon me kuletën e huaj që me ua rritë pagesën nga 250 në 300 euro. E di shumë mirë frustrimin e juaj për Zborcin sepse aty keni mbledh vota e asnjë projekt nuk e keni bërë. Po i garantoj banorët e Zborcit përmes këtijë mikrofoni se kjo parcel gjindet në Z.K-Shtime, dhe nuk është në Zonën Kadastrale – Zborc, dhe po ashtu nuk është fare afër vendbanimit, ka rreth një kilometër larg shtëpive të fshatit Zborc, dhe po ashtu është rreth gjysëm kilometri në thellësi të rrugës së fshatit Zborc. Ky është një projekt i Qeverisë së Republikës së Kosovës në vlerë rreth 12.5 milion euro i destinuar vetëm për këtë Institucion, i cili do ti plotësojë kushtet për një jetë të dinjitetshme të këtyre banorëve. Sa i përket këtyre sëmundjeve kronike psikike, sipas mjekëve janë në trndin e rritjes. Trajtimi i dinjitetshëm të kësaj kategorie është njerëzorë dhe human, prandaj kërkesa e një mjeku me i largu këtë kategori nuk është as njerëzore e as humane. Ne duhet të ndjehemi krenarë për trajtimin e kësaj kategorie. Kjo pra përveq të tjerave është edhe detyrë fisnike e jona. Ky projekt tani është në procedurë të prokurimit publik dhe do të kryhet së shpejti. Sqarimet janë për qytetarët sepse ata më së miri e dinë se kush ka abuzuar me interesin publik, e kush po merret me projekte konkrete në të mirën e tyre.

z.Përparim Ramusa: Këtu i ke nënshkrimet e banorëve. Ti do mi mbledhë të gjithë të sëmurit kronik, nga të gjitha komunat dhe po i bjen në Shtime.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Toka për ndërtim nuk është në teritorin e fshatit Zborc. Edhe ashtu ti nuk ke moral me folë për fshatin Zborc, sepse nuk keni bërë asgjë për këtë fshat të lindjes. Ky është mjek dhe shikoni se si flet për këtë kategori të sëmurëve kronik psiçik. Kjo është për me të ardhur keq.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora: 15:34h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

